

2.7 SISTEMI I PAGESAVE

Operimi në terma të sigurta dhe efikase i sistemeve të pagesave, si baza e tregjeve financiare, përbën një parakusht thelbësor për zbatimin e politikës monetare, stabilitetin financiar dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi. Me qëllim përmbushjen e objektivave në fushën e sistemeve të pagesave, Banka e Shqipërisë edhe përgjatë vitit 2017 ka intensifikuar përpjekjet për nxitjen e stabilitetit të tyre dhe garantimin e qarkullimit të sigurt, të shpejtë dhe me kosto të ulët të parasë në ekonomi. Në këtë kuadër, janë marrë masa me qëllim rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave dhe instrumenteve të pagesave, si dhe komponentëve përbërës të tyre. Gjithashtu, në mbështetje të këtyre objektivave, Banka e Shqipërisë ka luajtur një rol më proaktiv, në kuadër të nxitjes së iniciativave të aktorëve të tregut.

MBIKËQYRJA E SISTEMEVE TË PAGESAVE

Në kuadër të konsolidimit të mëtejshëm të funksionit mbikëqyrës të sistemeve të pagesave, përgjatë vitit 2017, Banka e Shqipërisë ka punuar për zbatimin e parimeve ndërkombëtare mbikëqyrëse në këto sisteme. Zbatimi i këtyre parimeve, garanton sigurinë e sistemeve dhe promovon efikasitetin e tyre duke mbështetur përdorimin sa më të gjerë nga tregjet financiare dhe agjentët ekonomikë, çka nxit formalizimin e ekonomisë shqiptare dhe ndërmjetësimin financiar.

Më konkretisht, gjatë vitit 2017, Banka e Shqipërisë ka punuar për zbatimin e parimeve të Bankës Ndërkombëtare për Rregullim "Mbi infrastrukturën e tregjeve financiare"³², si dhe të rregullores së Bankës Qendrore Evropiane nr. 795/2014 "Për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave me rëndësi sistemike"³³ nën mbështetjen e ekspertëve të Bankës së Italisë dhe të Bankës Botërore. Vlerësimi i sistemeve të pagesave në bazë të këtyre parimeve, si dhe marrja e masave për zbatim të tyre, vlerësohet të mbështesë jo vetëm sigurinë dhe efikasitetin e këtyre sistemeve në nivel vendi, por dhe nxitjen e besueshmërisë së tyre në nivel ndërkombëtar, si dhe krijimin e parakushteve të nevojshme drejt aderimit në tregun e përbashkët evropian.

Në përmbushje të objektivave afatmesëm të zhvillimit, Banka e Shqipërisë i ka kushtuar vëmendje të veçantë edhe zhvillimit dhe rregullimit të sistemeve të pagesave me vlerë të vogël dhe instrumenteve të përdorura në to. Për sa më sipër, Banka e Shqipërisë, përgjatë vitit 2017, ka punuar për përshtatjen e kuadrit ligjor dhe rregullativ vendas me Direktivën e Shërbimeve të Pagesave.

³² <https://www.bis.org/cpmi/publ/d101a.pdf>

³³ https://www.ecb.europa.eu/ecb/legal/pdf/oj_joL_2014_217_r_0006_en_txt.pdf



Krijimi dhe zbatimi i këtij kuadri ligjor dhe rregullativ vlerësohet të kontribuojë në nxitjen e konkurrencës në tregun e shërbimeve të pagesave, në rritjen e transparencës në shërbimet e ofruara nga tregu dhe në krijimin e një kuadri të konsoliduar për mbrojtjen e konsumatorit. Gjithashtu, përafrimi i praktikave të rregullimit të tregut të shërbimeve të pagesave me ato evropiane përbën një hap themelor në lidhje me integrimin dhe zbatimin e rekomandimeve në kuadër të lëvizjes së lirë të kapitalit dhe aderimin në Tregun e Vetëm të Pagesave në Euro (SEPA). Së fundi, krijimi i bazës ligjore dhe rregullative të sipërcituar vlerësohet të kontribuojë dhe në nxitjen e zhvillimit të shërbimeve inovative, por gjithnjë të zhvilluara në terma të sigurta dhe efikase.

Përtej përbushjes së objektivave afatmesëm të sipërcituar, gjatë vitit 2017, Banka e Shqipërisë ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me sistemin bankar dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave me qëllim nxitjen e zhvillimit të tregut të sistemeve dhe instrumenteve të pagesave, nëpërmjet nxitjes së diskutimeve mbi zhvillimet më të fundit, si dhe akomodimin e nevojave për përshtatje rregullative, të cilat nxisin efikasitetin e këtyre sistemeve dhe instrumenteve.

ROLI REFORMATOR I BANKËS SË SHQIPËRISË NË FUSHËN E SISTEMEVE TË PAGESAVE

Një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e tregjeve financiare dhe të pagesave, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe besueshmërisë së këtyre tregjeve dhe infrastrukturave përkatëse, zë dhe funksioni reformator/ katalizator i Bankës së Shqipërisë. Për të përbushur këtë qëllim, Banka e Shqipërisë shfrytëzon ekspertizën e saj në fushën e sistemeve të pagesave dhe e ndan atë me aktorët e tregut nëpërmjet konsultimeve të rregullta dhe takimeve të koordinuara me përfaqësues të sektorit privat dhe publik. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë ka vijuar punimet me qëllim konsolidimin e bashkëpunimit ndërinstitucional nëpërmjet funksionimit të Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP).

Nëpërmjet Komitetit, Banka e Shqipërisë ka intensifikuar aktivitetin kërkimor në nivel ndërinstitucional, duke synuar rritjen e transparencës dhe edukimin e publikut si një mjet të rëndësishëm për nxitjen e zhvillimit të tregut. Më konkretisht, në mbledhjen e radhës, KKSP-ja ka iniciuar një sërë projektesh me qëllim hulumtimin e çështjeve me prioritet për tregun, në bashkëpunim me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjithashtu, përgjatë vitit 2017, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe institucione qeveritare si Ministri i Shtetit për Diasporën, është angazhuar dhe në fushën e dërgesave në para të emigrantëve. Në këtë kuadër, vëmendje i është kushtuar vlerësimit të tregut të remitancave, si dhe përpjekjeve për rritjen e eficiencës së këtij burimi të rëndësishëm për ekonominë e vendit.



Së fundi, vëmendje e veçantë gjatë kësaj periudhe i është kushtuar edhe ndërveprimi me aktorë të ndryshëm të tregut dhe palë të interesuara për t'u përfshirë në tregun shqiptar të sistemeve dhe shërbimeve të pagesave.

KOMITETI KOMBËTAR I SISTEMIT TË PAGESAVE

Me qëllim nxitjen e zhvillimit të sistemeve dhe instrumenteve të pagesave, KKSP-ja edhe përgjatë vitit 2017 ka vijuar përpjekjet për materializimin e objektivave të synuar. Në mbledhjen e organizuar në maj të vitit 2017 u iniciuan një sërë projektesh, të cilat vlerësohet se do të kontribuojnë në krijimin e parakushteve të nevojshme për nxitjen e reformimit të tregut të pagesave me vlerë të vogël, dhe si rrjedhojë promovimin e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave.

Në terma konkretë, në mbledhje, institucionet anëtare të KKSP-së u angazhuan për:

- Nxitjen e përfshirjes financiare nga pikëpamja e pagesave. Anëtarët u angazhuan në zbatimin e rekomandimeve, të cilat synojnë të adresojnë hapësirat e evidentuara nga raporti i hartuar nga Banka Botërore në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë për përfshirjen financiare nga pikëpamja e pagesave. Raporti analizon tregun dhe adreson rekomandime në bazë të shtatë parimeve kryesore, si vijon: a) përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ në zbatim; b) zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturave për shërbimet financiare; c) zgjerimin e zotërimit në llogaritë e pagesave dhe përdorimit të shërbimeve të tyre; d) zgjerimin e pikave të aksesit të këtyre shërbimeve; e) rritjen e edukimit dhe ndërgjegjësimit financiar; f) rritjen e vëllimeve të transaksioneve të procesuara nga sistemet e pagesave; si dhe g) nevojën për angazhim ndërinstitucional si të sektorit publik ashtu edhe atij privat, i cili është tejet i rëndësishëm për zbatimin e rekomandimeve.
- Hartimin dhe zbatimin e një projektstrategjie për reformimin e tregut të pagesave me vlerë të vogël me mbështetjen e ekspertizës së Bankës Botërore. Strategjia do të shërbejë si një strategji afatmesme zhvillimi e KKSP-së për nxitjen e zhvillimit në këto sisteme, nëpërmjet një planveprimi për të gjithë aktorët e tregut. Strategjia e sipërcituar paraqet dhe mjetet e monitorimit mbi zbatimin e saj, si dhe përcakton objektiva sasiore. Aktualisht, hartimi i strategjisë është finalizuar dhe do të miratohet në mbledhjen e radhës së KKSP-së.
- Finalizimin e studimit mbi matjen e kostove të instrumenteve të pagesave në Shqipëri. Kryerja e një studimi të tillë është vlerësuar shumë efektive nga bankat qendrore të vendeve të zhvilluara si në kuadër të luftës kundër përdorimit të parasë fizike në ekonomi, ashtu edhe në kuadër të identifikimit të mundësive për reduktimin e kostove që mbart përdorimi i instrumenteve të pagesave në ekonomi. Studimi i sipërcituar, është finalizuar nga Banka e Shqipërisë dhe Banka Botërore dhe do të bëhet publik brenda muajve të parë të vitit 2018.




- Analizimin e tregut të remitancave në Shqipëri dhe zbatimin e projektit *Greenback*, të Bankës Botërore në qytetin e Beratit. Projekti i sipërpërmendur konsiston në rritjen e përfshirjes financiare dhe edukimit financiar të emigrantëve dhe familjeve të tyre, si pritës të këtyre fondeve, si dhe krijimin e kanaleve sa më efikase në terma të kostove për dërgimin e fondeve.
- Hartimi i projektligjit për shërbimet e pagesave. Duke i konsideruar shërbimet e pagesave, si dhe instrumentet e lidhura me to, si një komponent të rëndësishëm të sistemeve të pagesave, Banka e Shqipërisë ka punuar për zbatimin e Direktivës së Bashkimit Evropian 2015/2366 “Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm”. Zbatimi në praktikë i kësaj direktive vlerësohet të kontribuojë ndjeshëm në përmirësimin e sigurisë dhe efikasitetit të shërbimeve të pagesave, nëpërmjet nxitjes së konkurrencës, rritjes së kushteve të transparencës dhe përcaktimit të qartë të të drejtave dhe detyrimeve të ofruesve dhe përdoruesve të këtyre shërbimeve. Gjithashtu, direktiva krijon kushte për adresimin e duhur të rreziqeve, të mbartura nga zbatimi i risive teknologjike (Fin-Tech) në shërbimet e pagesave. Aktualisht, Banka e Shqipërisë është në proces finalizimi të projektligjit. Megjithatë, duke vlerësuar ndikimin e gjerë të këtij projektligji, konsultimi me aktorët e tregut paraqet një rëndësi të veçantë.
- Së fundi, por jo me më pak rëndësi, gjatë kësaj periudhe është punuar për rishikimin e kuadrit rregullativ për organizimin dhe funksionimin e KKSP-së, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes në KKSP edhe të institucioneve të shërbimeve të pagesave dhe transfertave, atyre të parasë elektronike dhe operatorëve të sistemeve të shlyerjes dhe klerimit. Ky rishikim vjen në përgjigje të rekomandimeve të Bankës Botërore për zbatimin e praktikave më të mira ndërkombëtare.

ECURIA E SISTEMEVE AIPS DHE AECH

SISTEMI I SHLYERJES SË PAGESAVE NDËRBANKARE ME VLERË TË MADHE (AIPS)

Në përmbushje të objektivave të Bankës së Shqipërisë, sistemi AIPS, infrastruktura bazë për shlyerjen e tregjeve financiare, ka reflektuar siguri dhe efikasitet gjatë vitit 2017, duke shmangur incidentet dhe shmangie nga rregullat e operimit. Në sistemin AIPS, u shlye një vëllim prej 125,641 transaksionesh me një vëllim total të likuiditetit të qarkulluar në sistem prej 8,472 miliardë lekësh. Krahasuar me një vit më parë, vëllimi dhe vlera e transaksioneve të shlyera janë rritur përkatësisht me 3% dhe 10%. Gjithashtu, prirje në rritje paraqet dhe vlera e transaksioneve të procesuara në AIPS në raport me PBB-në, duke diktuar një përdorim gjithnjë e më të madh të sistemit, dhe rëndësinë e këtij sistemi për ekonominë shqiptare.






Nga pikëpamja e përdorimit të sistemit AIPS, peshën më të lartë në terma të vëllimit e zënë "Pagesat për klientët³⁴" (53.46% pagesa të gjeneruara nga individë, biznese dhe institucione shtetërore), duke diktuar rëndësinë e sistemit në ndërmjetësimin e aktivitetit ekonomik. Nga ana tjetër, zërin kryesor në terma të vlerës e zënë "Shlyerje nga sistemi AFISAR" (40.35%) për shlyerjen e transaksioneve me tituj, duke diktuar rëndësinë e sistemit nga pikëpamja e shlyerjes së tregjeve financiare dhe zbatimit të politikës monetare.

Mirëfunksionimi i sistemit AIPS nxit zhvillimin e tregjeve financiare, duke akomoduar nevojat për shlyerje të infrastrukturave mbështetëse bazuar në hapësirat rregullative për funksionimin e sistemit. Për sa më sipër, iniciativat

private dhe publike mund t'i shfrytëzojnë këto hapësira për garantimin e një shlyerjeje sa më të sigurt në librat e Bankës së Shqipërisë.



Nga pikëpamja e adresimit të rreziqeve, rritja e aktivitetit të sistemit AIPS nuk është shoqëruar me nevoja për mbështetje me likuiditet nga Banka e Shqipërisë. Më konkretisht, Kredia Brenda Ditës (KBD) është ulur si në terma të numrit, ashtu edhe të vlerës (përkatësisht me 22% dhe 26%), duke reflektuar edhe një rënie të vlerës mesatare për transaksion. Ky zhvillim reflekton një rënie të ekspozimit të sistemit ndaj rrezikut të likuiditetit (Grafiku 37), ku raporti i KBD-së ndaj vlerës së shlyer në AIPS (miliardë lekë) ka pësuar rënie të konsiderueshme gjatë vitit 2017. Prirja gjithnjë e në rënie e nevojës për financim të aktivitetit të sistemit AIPS me KBD, përtej kushteve të


³⁴ Nxitje e përdorimit të sistemit AIPS nga aktorët ekonomikë pas masave të marra nga Banka e Shqipërisë në vitin 2011 mbi komisionet e aplikuar për përdoruesit fundorë.



likuiditetit në treg, dikton dhe mënyrën e re të përdorimit të këtij instrumenti dhe administrimit të kolateralit për garantimin e tij nëpërmjet sistemit AFISAR.

SISTEMI I KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL (AECH)

Në sistemin AECH, gjatë vitit 2017, janë kleruar 553,433 pagesa, me një vlerë mesatare për transaksion prej rreth 180,000 lekësh. Krahasuar me një vit më parë, aktiviteti i sistemit AECH ka pasqyruar një rritje për sa i përket vëllimit dhe vlerës së pagesave të kleruara përkatësisht prej 9% dhe prej 8.5%.



Nga shpërndarja e pagesave sipas pjesëmarrësve, ka vijuar të rritet përdorimi i sistemit me vlerë të vogël nga bankat, për pagesat e klientëve të tyre. Më konkretisht, për sa i përket aktivitetit bankar, kemi një rritje të ndjeshme të numrit të transaksioneve prej 16.12%, si dhe të vlerës së tyre prej 13.85%, krahasuar me vitin 2016, duke arritur në një nivel përdorimi të sistemit për këtë qëllim në masën 60% ndaj totalit të aktivitetit (40% transaksionet për Ministrinë e Financave). Prirja në rritje e numrit të transaksioneve nga bankat, tregon familjarizimin e publikut me instrumentet e pagesave dhe përdorimin e tyre në nivel ndërbankar, si dhe përcimin e masave të marra nga Banka e Shqipërisë në vitin 2011 mbi komisionet e aplikuara nga bankat në përdoruesit fundorë.

Duke vlerësuar kontributin e sistemit AECH në nxitjen e përdorimit të instrumenteve të pagesave, Banka e Shqipërisë ka vijuar përpjekjet për nxitjen e zgjerimit të instrumenteve të kleruara në të, si dhe të aktorëve të cilët klerojnë pagesa nëpërmjet këtij sistemi. Një mbështetje e konsiderueshme në këtë drejtim vlerësohet të ketë dhe zbatimin e projektit "Për shërbimet e pagesave".

Nga pikëpamja e reziqeve, vlen të theksohet se shpërndarja e transaksioneve të kleruara në sistemin AECH sipas seancave, ka një përqendrim më të lartë



në seancën e parë të klerimit. Zhvillimi i sipërcituar shmang mbingarkesat në flukset e pagesave në seancën e fundit të klerimit, duke minimizuar rreziqet e mbartura nga këto mbingarkesa.


INSTRUMENTET E PAGESAVE

Nxitja e përdorimit të instrumenteve të pagesave për shkëmbimet midis aktorëve ekonomikë, dhe kryesisht atyre në formë elektronike, të cilat paraqiten më efikase, është tejet e rëndësishme për ekonominë shqiptare nëse merret në konsideratë fakti që përdorimi i parasë fizike në ekonomi mbart një kosto prej rreth 1.7% të PBB-së³⁵ për ekonominë shqiptare. Në këtë kuadër, zhvillimet e tregut janë në monitorim të vazhdueshëm nga Banka e Shqipërisë, me qëllim nxitjen e zhvillimeve si nëpërmjet kuadrit rregullativ, ashtu edhe nëpërmjet zhvillimeve infrastrukturore në përmbushje të objektivit afatmesëm për garantimin e qarkullimit të sigurt, të shpejtë dhe me kosto të ulët të parasë në ekonomi.

Raportimet e bankave për instrumentet e pagesave, tregojnë se në vitin 2017 janë kryer rreth 13.3 milionë pagesa nga individët dhe bizneset, me një vlerë totale prej 4,665 miliardë lekësh. Zhvillimi i sipërcituar dikton një shtim të numrit dhe vlerës së pagesave të kryera nëpërmjet instrumenteve të pagesave përkatësisht me 11.18% dhe 3.41% krahasuar me vitin 2016.

Nga totali i numrit të pagesave të klientëve, edhe përgjatë kësaj periudhe vihet re një përdorim i lartë i transfertave të kreditit (në masën 61.33%), nga të cilat rreth 72.2% janë pagesa të instrukuara në formë letër. Pavarësisht këtij zhvillimi, vitet e fundit, vihet re një prirje në rritje e përdorimit të instrumenteve elektronike si transfertat në formë joletër (*home banking*), dhe e atyre me karta.

Grafik 39. Ecuria e numrit të instrumenteve të pagesave në vite-numër (majtas) dhe përdorimi i instrumenteve të pagesave, gjatë 2017, nga individët dhe bizneset (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

³⁵ Vlerësimi nga studimi i Bankës së Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën Botërore.



HOME BANKING


Shërbimet *home banking*³⁶ po gjejnë një përdorim gjithnjë e më të gjerë në tregun shqiptar. Promovimi i përdorimit të këtij instrumenti në tregun tonë, si një nga instrumentet me efikasitet më të lartë në terma të produktivitetit dhe të kostove të mbartura nga përdorimi, bazuar në studimet e Bankës së Shqipërisë mbi kostot e instrumenteve të pagesave, vlerësohet si tejet i rëndësishëm.

Nga pikëpamja e ofrimit të shërbimit, evidentohet se në fund të vitit 2017, 14 nga 16 banka ofrojnë produkte të ndryshme *home banking*. Krijimi i kushteve të përshtatshme nga kahu i ofertës (bankat) është reflektuar në një prirje gjithnjë e në rritje të përdorimit të këtyre shërbimeve. Më konkretisht, edhe në vitin 2017 vihet re një rritje e konsiderueshme prej 26.32% e vëllimit të pagesave *home banking* dhe e vlerës së këtyre transaksioneve prej 60.11%, krahasuar me një vit më parë.

Prirja gjithnjë e në rritje e përdorimit të *home banking*, lidhet ngushtë me ekzistencën e infrastrukturës, si edhe me përhapjen e mundësive për ta aksesuar internetin edhe përmes një *smart phone*. Rol pozitiv vlerësohet të kenë luajtur edhe politikat e bankave, në promovimin e këtyre mënyrave alternative të pagesave, çka është reflektuar në shtimin e llogarive të aksesueshme në distancë ndaj totalit të llogarive, nga rreth 1% në vitin 2008 në rreth 11% në vitin 2017.

Megjithatë, zgjerimi i numrit të llogarive nuk është shoqëruar me një shtim të transaksioneve për llogari. Ky zhvillim reflekton nevojën për familjarizim të klientëve të bankave me shërbimin, duke nënkuptuar dhe hapësirat për ndërhyrje në kuadër të edukimit financiar të publikut dhe fushatave sensibilizuese në këtë drejtim.

Grafik 40. Ecuria e përqindjes së llogarive të aksesueshme nga interneti ndaj totalit të llogarive, dhe ecuria e raportit të shfrytëzimit të llogarive të aksesueshme nga interneti*



*Raporti i utilizimit tregon sa përdoret mesatarisht një llogari me akses nga interneti për kryerje transaksionesh.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

KARTAT BANKARE

Në Republikën e Shqipërisë, në fund të vitit 2017, rezultojnë 14 banka të licencuara si emetuese kartash, 9 nga të cilat janë të licencuara edhe si pranuese kartash.

Infrastruktura e ofruar nga bankat e licencuara si emetuese kartash dhe ato të licencuara si pranuese kartash, tregon se, në fund të vitit 2017, numri i terminaleve POS ka shënuar një rritje prej përkatësisht 2.57%, ndërkohë që numri i ATM-ve ka pësuar një rënie me 6.63%, krahasuar me vitin 2016.

³⁶ Këto produkte mundësojnë aksesimin e llogarisë bankare në distancë, nëpërmjet një linje interneti, linje telefoni apo një software-i që banka i vë në dispozicion klientit të saj.




Pavarësisht prirjes pozitive të shtimit në numër të terminaleve POS, përqendrimi i tyre vijon të jetë i lartë në qarkun e Tiranës,³⁷ në masën 85.95%. Vlen të theksohet se numri i POS-ve për 1.000.000 banorë rezulton në 2,541, çka paraqet nivelin më të ulët krahasuar me vendet e tjera të rajonit, e ndjekur nga Kosova me një nivel 5,982 POS për 1.000.000 banorë.

Zhvillime mjaft pozitive kanë shënuar dhe терминаlet për përdorimin e kartave me para elektronike, të cilat vijojnë të paraqesin ritme rritëse në masën 104.56% krahasuar me fundin e vitit 2016. Megjithatë, duhet theksuar se kjo rritje reflekton dhe efektin statistikor të bazës së ulët krahasuese. Nxitja e përdorimit të instrumenteve të parasë elektronike vlerësohet të ketë ndikim në përfshirjen financiare të popullsisë, duke mundësuar aksesin në shërbime bankare (hapjen e një llogarie paraqe elektronike dhe zotërimin e një karte të parapaguar) nga kategori të popullsisë të cilat nuk mund të kenë akses në shërbime të tjera, si për shembull nuk janë pagamarrës.

Gjatë vitit 2017, vihet re një rritje me 4.9% e emetimit të kartave të debitit dhe me 12.1% e kartave të kreditit. Gjithashtu, funksionimi në treg i kartave me funksion paraqe elektronike, ka paraqitur ritme të shpejta rritëse.

Nga përdorimi i kartave bankare në терминаlet ATM dhe POS, rezulton se, peshën kryesore të transaksioneve të procesuara me karta e zënë tërheqjet cash nga ATM-të, tregues ky i një ekonomie ende me përdorim të lartë të cash-it. Gjatë vitit 2017, vërehet një rënie e numrit dhe e vlerës së pagesave



³⁷ Ndarja e qarqeve bëhet sipas degëve të Bankës së Shqipërisë.



me karta në POS-e fizike dhe virtuale, përkatësisht me 7.8% dhe me 24.9%. Në terma relativë, pagesat e kryera me karta të parapaguara arrijnë deri në 8.37% të pagesave me karta debiti dhe krediti. Krahasuar me vitin e kaluar, kemi një rritje të pagesave me këto karta prej 18.47%. Përdorimi jo i lartë i kartave si mjet pagese reflekton nivelin e familjarizimit të publikut, edukimin e ulët financiar, si dhe infrastrukturën e kufizuar të POS-eve nga ana e bizneseve.

TRANSAKSIONET ME PARA FIZIKE

Për sa i përket transaksioneve me para fizike (cash) të kryera nga klientët në sportelet e bankave, për vitin 2017, vihet re një ulje në numër krahasuar me një vit më parë. Përkatësisht këtë vit është shënuar një ulje e lehtë e transaksioneve në arkë me 5.48% në terma të numrit dhe një rritje e lehtë me 0.82% në terma të vlerës, krahasuar me një vit më parë.

Tabelë 6. Numri dhe vlera e transaksioneve cash në sportelet e bankave

Përshkrimi	Viti 2016		Viti 2017		Ndryshime vjetore	
	Numër	Vlerë (mln Lekë)	Numër	Vlerë (mln Lekë)	Numër	Vlerë
Transaksione cash në Arkë	11,388,857	2,572,650	10,765,198	2,593,771	-5,48%	0,82%
1. Depozitime cash në Arkë	7,645,500	1,577,539	7,175,011	1,608,616	-6,15%	1,97%
2. Tërheqje cash në Arkë	3,743,357	995,111	3,590,187	985,155	-4,09%	-1,00%

Burimi: Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave".

Pavarësisht uljes së përdorimit të parasë fizike, nga perspektiva e tërheqjeve dhe depozitimeve në sportelet e bankave në vitin 2017, përdorimi i parasë fizike në ekonominë shqiptare është një fenomen mbizotërues³⁸, i cili mbart kosto të larta për aktorët e ndryshëm dhe ekonominë në përgjithësi. Në këtë kuadër, bashkërendimi i përpjekjeve në nivel tregu për nxitjen e përdorimit të instrumenteve sa më efikase dhe me kosto të ulëta paraqesin një rëndësi të veçantë dhe përbëjnë një nga prioritetet e Bankës së Shqipërisë.

³⁸ Nga një studim i Bankës së Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën Botërore rezulton se nga bizneset e anketuara, 99.2% e të gjitha pagesave janë pranuar në para fizike (cash), ndërsa 66% e pagesave të kryera nga ta janë kryer gjithashtu në cash. Gjithashtu, nga ana e konsumatorëve shqiptarë diktohet një përdorim i lartë i parasë fizike (96% e pagesave të kryera nga konsumatorët rezultojnë në cash, ndërkohë që pagesat e marra për ta nga të tretët, 90% e tyre rezultojnë të kryhet në cash).

